



Nr. 01/2023
Data:18.08.2023

THIRRJE PUBLIKE

PËR MBËSHTETJEN E KONSUMATORËVE FAMILJARË NË INVESTIMIN NË PAJISJE SHTËPIAKE EFIÇIENTE

Që nga viti 2021, kriza energjetike nëpër të cilën po kalon Evropa ka përkeqësuar situatën me furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike edhe për qytetarët e Republikës së Kosovës. Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme të prodhimit vendor të energjisë elektrike, varësia nga importi dhe çmimet jostabile të energjisë elektrike në tregun ndërkombëtar kanë krijuar pasiguri në furnizimin me energji elektrike. Një situatë e tillë vlerësohet që pengon edhe zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës, duke shkaktuar rrjedhimisht kosto të larta për ekonominë familjare si dhe për bizneset.

Sipas statistikave, konsumatori më i madh i energjisë elektrike në Republikën e Kosovës është sektori rezidencial, i cili kontribuon me rreth dyzet përqind (40%) në konsumin final të saj. Ulja e konsumit përmes rritjes së Efiçencës së Energjisë (EE) ndikon në reduktimin e kërkesës për energji elektrike duke ndihmuar familjet për të reduktuar faturat e energjisë elektrike, por edhe për të përmirësuar sigurinë e furnizimit.

Qeveria e Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh këtë situatë të paqëndrueshme të furnizimit me energji elektrike, ka ndërmarr masa konkrete në adresimin e saj. Në linjë sipas Vendimit¹ Nr. 29/112, datë 13.12.2022, i plotësuar me Vendimin² Nr.03/128, datë 16.02.2023, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar Planin e Veprimit për Zbutjen e Ndikimit të Menjëhershëm Socio-Ekonomik të Krizës Energjetike në shumë prej shtatëdhjetë e pesë (75) milionë euro, si parakusht për përfitimin e mjeteve financiare nga Bashkimi Evropian (BE) për Programin Vjetor IPA 2023. Ky Plan parashih zbatimin e masave me efekte të menjëhershme dhe afatshkurtra për periudhën e dimrit, përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë financiare për familjet në nevojë dhe në disavantazh social, nxitjen e kursimit të energjisë elektrike nga konsumatorët familjarë, mbështetjen e familjeve përmes rritjes së Efiçencës së Energjisë (EE)

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30>

² <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30>



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



Funded by
the European Union

në njësitë e banimit dhe të ndërtesave si dhe investimeve në pajisje efçiente për ngrohje dhe elektro-shtëpiake dhe sisteme të energjisë së ripërtëritshme për familjet.

Bazuar në Masën katër (4) të Planit të Veprimit për Zbutjen e Ndikimit të Menjëhershëm Socio-Ekonomik të Krizës Energjetike, Ministria e Ekonomisë (ME), shpall Thirrje Publike për mbështetjen e konsumatorëve familjarë, në veçanti konsumatorët në nevojë, në investimin në pajisje elektro-shtëpiake efçiente duke përfshirë:

- ✓ *Makina rrobalarëse;*
- ✓ *Makina enëlarëse;*
- ✓ *Frigorifer ose frigorifer me ngrirëse.*



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Ekonomisë

Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



Funded by
the European Union

1 PAJISJET TË CILAT DO TË SUBVENCIONOHEN PËR KONSUMATORËT FAMILJARË

Secili aplikues gëzon të drejtën e përfitimit të subvencionit nga një (1) deri në tri (3) pajisjet e mëposhtme, por subvencionimi është i kufizuar për një (1) njësi (copë) prej secilës prej pajisjeve:

- ✓ *Makina rrobalarëse (Vërejtje: Makina rrobalarëse+tharëse nuk subvencionohet;*
- ✓ *Makina enëlarëse;*
- ✓ *Frigorifer ose frigorifer me ngrirëse;*

* Subvencionohen vetëm pajisjet e reja.

2 KRITERET TEKNIKE DHE TË PËRGJITHSHME

Në tabelën më poshtë gjeni kriteret për aplikim, kriteret teknike, vlerën e subvencionit dhe sqarimet shtesë për secilën prej pajisjeve që do të subvencionohen.

Tabela 1.0

PAJISJA	KRITERET PËR APLIKIM	KRITERET TEKNIKE TË PAJISJES	VLERA E SUBVENCIONIMIT	SQARIME SHITESË
	a. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë konsumatorët familjar, konsumi mujor i energjisë elektrike i të cilëve nuk është më i vogël se	a. Klasa e energjisë së pajisjes sipas etiketave të reja të Bashkimit Evropian (BE)	Vlera e subvencionimit për një (1) pajisje është 200.00 €.	Nëse vlera e faturës është më vogël se sa vlera e subvencionimit atëherë



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Ekonomisë

Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



Funded by
the European Union

Makina rrobalarëse³	250 kWh/muaj në të paktën dhjetë (10) muaj brenda dymbëdhjetë (12) muajve të fundit.	nga viti 2021 duhet të jetë A ose B. b. E pajisur me etiketën e konformitetit CE.	Për prindërit vetushqyes ⁴ vlera e subvencionimit për një (1) pajisje është 300.00 € . Për qytetarët që janë në mbështetje të skemës së ndihmës sociale (kategoria I & II), vlera e subvencionimit për një (1) pajisje është 400.00 € .	subvencionohet vetëm vlera e faturës.
Makina enëlarëse	a. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë konsumatorët familjar, konsumi mujor i energjisë elektrike i të cilëve nuk është më i vogël se 250 kWh/muaj në të paktën dhjetë (10) muaj brenda	a. Klasa e energjisë së pajisjes duhet të plotësojë njëri nga kriteret e mëposhtme (në rast se pajisja ka etiketën e re dhe të vjetër, referojuni etiketës së re):	Vlera e subvencionimit për një (1) pajisje është 150.00 € . Për prindërit vetushqyes ⁶ , vlera e subvencionimit për një	Nëse vlera e faturës është më vogël se sa vlera e subvencionimit atëherë subvencionohet vetëm vlera e faturës.

³ Makina rrobalarëse + tharëse nuk përfshihet në subvencion

⁴ “Prindi vetushqyes” përkufizohet si prind apo kujdestar ligjor i fëmijës deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, që jeton me fëmijën dhe është përgjegjës i vetëm ligjor dhe financiar i fëmijës. Ligji Nr. 2003/15 Për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë.

⁶ “Prindi vetushqyes” përkufizohet si prind apo kujdestar ligjor i fëmijës deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, që jeton me fëmijën dhe është përgjegjës i vetëm ligjor dhe financiar i fëmijës. Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë.

**Republika e Kosovës**

Republika Kosova- Republic of Kosovo

Qeveria- Vlada- Government

Ministria e Ekonomisë

Ministarstvo Ekonomije - Ministry of EconomyFunded by
the European Union

	dymbëdhjetë (12) muajve të fundit ⁵ .	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Klasa e energjisë sipas etiketave të reja të Bashkimit Evropian (BE) nga viti 2021 duhet të jetë A,B,C ose D; ▪ Klasa e energjisë sipas etiketave të vjetra të Bashkimit Evropian (BE) para vitit 2021 duhet të jetë A+++. 	(1) pajisje është 250.00 € . Për qytetarët që janë në mbështetje të skemës së ndihmës sociale (kategoria I & II), vlera e subvencionimit për një (1) pajisje është 300.00 € .		
Frigorifer ose frigorifer me ngrirëse	a. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë konsumatorët familjar, konsumi mujor i energjisë elektrike i të cilëve nuk është më i vogël se 250 kWh/muaj në të paktën dhjetë (10) muaj brenda	b. E pajisur me etiketën e konformitetit CE.	a. Klasa e energjisë së pajisjes duhet të plotësojë njëri nga kriteret e mëposhtme (në rast se pajisja ka etiketën e re dhe të vjetër, referojuni etiketës së re):	(1) pajisje është 100.00 € . Për prindërit vetushqyes ⁸ vlera e subvencionimit për një	Nëse vlera e faturës është më vogël se sa vlera e subvencionimit atëherë subvencionohet vetëm vlera e faturës.

⁵ Në formularin për aplikim online e-Kosova, aplikantit do t'i kërkohej të shënojë shifrën e konsumatorit të faturës së energjisë elektrike (sipas faturës së KESCO), dhe përmes shifrës së konsumatorit nga kompania KESCO do të merren informatat mbi shpenzimet e konsumit të energjisë elektrike. Vlera minimale e konsumit të energjisë elektrike 250 kWh/muaj kërkohej si dëshmi që ndërtesa është e banuar.

⁸ “Prindi vetushqyes” përkufizohet si prind apo kujdestar ligjor i fëmijës deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, që jeton me fëmijën dhe është përgjegjës i vetëm ligjor dhe financiar i fëmijës. Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë.



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Ekonomisë

Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



Funded by
the European Union

	dymbëdhjetë (12) muajve të fundit ⁷ .	<ul style="list-style-type: none">▪ Klasa e energjisë sipas etiketave të reja të Bashkimit Evropian (BE) nga viti 2021 duhet të jetë A,B, C, ose D;▪ Klasa e energjisë sipas etiketave të vjetra të Bashkimit Evropian (BE) para vitit 2021 duhet të jetë A+++. <p>b. E pajisur me etiketën e konformitetit CE.</p>	(1) pajisje është 150.00 € . Për qytetarët që janë në mbështetje të skemës së ndihmës sociale (kategoria I & II), vlera e subvencionimit për një (1) pajisje është 200.00 € .	
--	--	--	--	--

⁷ Në formularin për aplikim online e-Kosova, aplikantit do t'i kërkohe të shënojë shifrën e konsumatorit të faturës së energjisë elektrike (sipas faturës së KESCO), dhe përmes shifrës së konsumatorit nga kompania KESCO do të merren informatat mbi shpenzimet e konsumit të energjisë elektrike. Vlera minimale e konsumit të energjisë elektrike 250 kWh/muaj kërkohe si dëshmi që ndërtesa është e banuar.



3 MËNYRA E APLIKIMIT PËR SUBVENCION

Aplikimi për subvencionim bëhet online përmes platformës e-Kosova.

Hapat për aplikim

1. Sigurohuni që plotësoni kriterin për aplikim në lidhje me konsumin e energjisë elektrike këtu: <https://ekosova.rks-gov.net/467>. Nëse e plotësoni këtë kriter ju mund të vazhdoni me blerjen e pajisjes/ve.
2. Pas blerjes së pajisjes/ve së përzgjedhur/a sipas kriterëve të specifikuar më lart, ju mund të vazhdoni aplikimin që të ju mundësohet përfitimi nga ky subvencion, duke plotësuar formularin për aplikim në linkun si më lart dhe duke ngarkuar dokumentet si në vijim:
 - a. Faturën e rregullt apo kuponin fiskal të blerjes së pajisjes (*data e faturës duhet të jetë nga data e shpalljes së thirrjes më 18.08.2023*);
 - b. Fotografi të pajisjes së blerë sipas kriterëve të specifikuar në thirrje;
 - c. Fotografi të numrit serik të pajisjes;
 - d. Fotografi të etiketës së konformitetit CE së pajisjes;
 - e. Për prindërit vetushqyes kërkohet të ngarkohet një (1) nga dokumentet/dëshmitë që konfirmon statusin e prindit vetushqyes;
 - f. Për aplikuesit që janë në mbështetje të skemës së ndihmës sociale (kategoria I & II), kërkohet të ngarkohet një (1) dëshmi që konfirmon statusin e aplikuesit që është përfitues i skemës sociale (kategoria I & II);
 - g. Marrëveshja juaj e subvencionimit do të gjenerohet automatikisht në platformën e-Kosova. Kjo marrëveshje duhet patjetër të shkarkohet, **të nënshkruhet**, dhe të ngarkohet së bashku me dokumentet e sipërpërmendura.

Në këtë fazë ju kërkohet të vendosni numrin e xhirollogarisë tuaj bankare e cila duhet të jetë në emër të aplikuesit dhe nga ndonjëra prej bankave të licencuara brenda Republikës së Kosovës.

Pas ngarkimit të dokumenteve të listuara më lartë në platformën online e-Kosova, ju do të pranoni një (1) njoftim automatik me përmbajtjen “Aplikimi juaj është realizuar me sukses. Aplikacioni juaj do të vlerësohet nga Komisioni përkatës i Ministrisë së Ekonomisë (ME), i cili



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



Funded by
the European Union

do të shqyrtojë nëse dëshmitë e ngarkuara në platformën e-Kosova janë konform kritereve të kësaj thirrjeje. Për rezultatet e aplikimit do të njoftoheni sipas afateve zyrtare”.

Nëse aplikacioni juaj vlerësohet pozitivisht nga Komisioni përkatës i Ministrisë së Ekonomisë (ME), ju do të njoftoheni përmes platformës e-Kosova dhe do të pranoni mjetet nga subvencioni në xhirlogarinë tuaj.

Pajisja duhet të jetë e instaluar dhe e gatshme për inspektim nga momenti që aplikoni.

Afati për aplikim

Afati i fundit për aplikim është dyzet e pesë (45) ditë kalendrike nga dita që hapet thirrja, pra deri më datën **2 tetor të vitit 2023**

E drejta për ankesë

Aplikantët të cilët vlerësojnë se aplikimi i tyre nuk është vlerësuar drejtë nga Komisioni përkatës i Ministrisë së Ekonomisë (ME), mund të ushtrojnë të drejtën e ankesës në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të njoftimit, konform Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA). Ankesa i drejtohet Ministrisë së Ekonomisë (ME) si autoritet që ka publikuar thirrjen në email adresën: **komisioni.ankesa@rks-gov.net**

Sqarime shtesë

Për më shumë informacione dhe sqarime shtesë rreth fazave të aplikimit mund të drejtoheni me shkrim në email adresën: ✉ **info.subvencionet@rks-gov.net** apo të kontaktoni në numrat e telefonit si më poshtë:

☎ 038 200 215 89

☎ 038 200 215 55

Nga e hëna deri të premten, duke filluar nga ora: 08:30-12:00 dhe nga ora 13:00-16:00




SHTOJCA 1: SQARIME RRETH ETIKETAVE TË ENERGJISË DHE KONFORMITETIT

Në tabelat në vijim gjeni sqarimet rreth klasave të energjisë së pajisjeve sipas etiketave të reja të Bashkimit Evropian (BE) nga viti 2021 dhe etiketave të vjetra të Bashkimit Evropian (BE) para vitit 2021, si dhe sqarimin se si duket etiketat e konformitetit për secilën nga pajisjet:

I. MAKINA RROBALARËSE

ETIKETA E ENERGJISË

Klasa e energjisë së pajisjes sipas etiketave të reja të Bashkimit Evropian (BE) nga viti 2021 duhet të jetë A ose B. Referojuni shembullit të mëposhtëm se si duket klasa e energjisë sipas etiketave të reja:



ETIKETA E KONFORMITETIT

E pajisur me etiketën e konformitetit CE e cila duket si në vijim:






II. MAKINA ENËLARËSE

ETIKETA E ENERGJISË

Klasa e energjisë sipas etiketave të reja të Bashkimit Evropian (BE) nga viti 2021 duhet të jetë A,B,C ose D. Referojuni shembullit të mëposhtëm se si duket klasa e energjisë sipas etiketave të reja:



ETIKETA E KONFORMITETIT

E pajisur me etiketën e konformitetit CE e cila duket si në vijim:






Republika e Kosovës
Republika Kosova- Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



Funded by
the European Union

Klasa e energjisë sipas etiketave të vjetra të Bashkimit Evropian (BE) para vitit 2021 duhet të jetë A+++.

Referojuni shembullit të mëposhtëm se si duket klasa e energjisë sipas etiketave të vjetra:



III. FRIGORIFER OSE FRIGORIFER ME NGRIRËSE




Republika e Kosovës
 Republika Kosova- Republic of Kosovo
 Qeveria-Vlada-Government
 Ministria e Ekonomisë
 Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



Funded by
 the European Union

ETIKETA E ENERGISJË

Klasa e energjisë sipas etiketave të reja të Bashkimit Evropian (BE) nga viti 2021 duhet të jetë A,B, C, ose D. Referojuni shembullit të mëposhtëm se si duket klasa e energjisë sipas etiketave të reja:



Klasa e energjisë sipas etiketave të vjetra të Bashkimit Evropian (BE) para vitit 2021 duhet të jetë A+++.

Referojuni shembullit të mëposhtëm se si duket klasa e energjisë sipas etiketave të vjetra:

ETIKETA E KONFORMITETIT

E pajisur me etiketën e konformitetit CE e cila duket si në vijim:





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



Funded by
the European Union

